

**Tiranë, më 19.11.2021**

**E nderuar Kryetare,**

**Të nderuar deputetë,**

Reforma në drejtësi dhe çdo shtyllë e saj është një proces që zhvillohet dhe ndërvepron në disa rrafshë institucionale. Në emërues të përbashkët të këtyre procesve qëndron vullneti i të gjithë institucioneve dhe mbështetja permanente e partnerëve tanë SHBA-së, BE-së dhe Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, që ka ndjekur dhe mbikqyrur nga dita e parë procesin e vettingut.

Çështja e zgjatjes së mandatit të KPK-së dhe KP-së është në linjë me qëllimin për të cilin u nis kjo reformë, i shërben interesit publik për pastrimin e sistemit nga gjyqtarët e prokurorët që kanë cenuar rëndë besimin tek drejtësia, por që thelb objektivi i synuar ka qenë dhe mbetet i njëjtë:

**Rivlerësimi i plotë i të gjithë subjekteve të ligjit nr. 84/2016:** gjyqtarë, prokurorë, ndihmësit/këshilltarët ligjorë si dhe inspektorë të sistemit të drejtësisë, kalimi i tyre nëpër filtra ligjorë hetimi administrativ të pavarur, të paanshëm dhe të gjithanshëm, mbështetur në parime kushtetuese e ligjore.

Krijimi i institucioneve të rivlerësimit kalimtar me parashikime dhe procedura të posaçme kushtetuese ligjore, janë garanci ligjore edhe të vetë procesit të rivlerësimit që kryejnë këto sruktura të mandatuara. Tashmë kanë kaluar në filtrat e vettingut të Komisionit mbi 60% e subjekteve dhe pjesa tjetër janë duke iu nënshtruar këtij procesi.

Presioni i afatit 5-vjeçar të mandatit të komisionerëve dhe rivlerësimi i plotë i të gjithë subjekteve ex-officio, është po aq sfidë sa edhe kryerja e këtij procesi me standardet që përcakton Kushtetuta dhe Ligji nr. 84/2016 dhe parimet mbi të cilat zhvillohet ky proces nga komisionerët e Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

Si institucione që kryejnë një proces *sui generis* dhe si institucione që “shterojnë” në kohë pas 5 vitesh nga mandnatimi i tyre (jo si KLGJ e KLP), **që objektivi i synuar të arrihet dhe procesi i vettingut të përfundojë nga këto institucione të posaçme kushtetuese**, duhet që afati i mandatit të tyre të rishikohet bazuar në analizën objektive të argumenteve.

Deri më tani institucioni i KPK-së, si shkallë e parë e vettingut, ka shortuar të gjithë subjektet dhe kemi në proces afro 40 % prej tyre, të cilëve u ka nisur hetimi administrative, apo janë në faza të ndryshme të këtyre procedurave. Tashmë strukturat e vettingut i kanë konsoliduar procedurat administrative, kanë shtuar ritmet e punës dhe rritur eficiencën, duke rritur ndjeshëm numrin e vendimmarrjes së realizuar. Por jo vetëm kaq, KPK i kanë dhënë prioritet edhe kërkesave të Këshillave për të vettuar me përparësi magjistratët kandidatë për pozicionet vakante të krijuara në system, si pasojë e moskalimit me sukses të vettingut të një numri të madh të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

Të nderuar,

Nëse sipas asaj cfarë parashikon Kushtetuta, mandati i KPK-së dhe IKP-së nuk zgjatet dhe procesi do të transferohet tek Këshillat, a do të kemi garantuar standardin e njëjtë për cdo subjekt që iu nënshtrua procesit nga KPK përkundrejt atyre që do t'i vettojnë Këshillat? A do të cenoheshin parimet kushtetuese e ligjore të këtij procesi dhe a do të duhet të kenë edhe Këshillat të njëjtin presion të përfundimit të vettingut për gjyqtarët e prokurorët e pavettuar nga KPK, krahas detyrave të tjera për qeverisjen e institucioneve të sistemit të ri të drejtësisë? A do të duhet të garantohen standarde të njëjta të hetimit administrativ me ato që ka kryer KPK, IKP dhe KPA, dhe me të njëjtin presion kohe që kërkohet të përfundoj ky proces kushtetues?

Që procesi i vettingut duhet të finalizohet kjo është e gjithpranuar tashmë, ndërsa në analizë të respektimit të parimeve, konsolidimit të standardeve dhe rezultatit të pritshëm, në raport me afatin e mandatit, analiza tregon se:

- 1- Në respekt të parimit të barazisë para ligjit, ato subjekte të cilëve nuk u ka përfunduar vettingu, duhet të kalojnë domosdoshmërisht nëpër të njëjtën procedurë dhe nga të njëjtat institucione, si të gjithë subjektet e tjerë të cilëve u ka përfunduar vettingu. Kalimi i më shumë se gjysmës së tyre nëpërmjet vettingut të kryer nga KPK dhe e pjesës së mbetur nëpërmjet KLGJ-së apo KLP-së, krijon mundësi për trajtim të pabarabartë dhe cenim të këtij parimi të gjithpranuar tashmë. Për rrjedhojë, zgajtja e mandatit të institucioneve të rivlerësimit bën që ky parim të mos cenohet dhe të gjithë të jenë të barabartë para ligjit dhe këtij procesi.

- 2- Këshillat nuk kanë përvojë në procesin e vettingut dhe mbi të gjitha kanë natyrë të ndryshme pune. Me transferimin e çështjeve të pavettuara, atyre do t'u duhet të angazhohen dhe marrin kohën e nevojshme për konsolidimin e procedurave të hetimit administrativ dhe garantimin e standardeve të një procesi të rregullt ligjor.
- 3- Nga pikëpamja e konsistencës së praktikës së krijuar nga organet e vettingut, eksperiencës së fituar dhe konsolidimit të procedurave administrative, zgjatja e mandatit të organeve të vettingut do të garantonte vijimësi dhe finalizim të vettingut për të gjithë subjektet e sistemit. Ndërsa transferimi i këtij procesi tek KLGJ e KLP do kërkonte: kohë, procedura, infrastrukturë e burime njerëzore shtesë, përfshirë edhe nevojën për trajnime të stafëve të tyre. Ndërkohë që presioni që vetë ky proces ka e duhet të ketë, është që të të përfundojë sa më parë, kushqo qoftë institucioni që e kryen atë.
- 4- Parë edhe në analizën e punës sonë 4-vjecare dhe rritjes së numrit të vendimeve të KPK-së, krahas energjive të shtuara si rrjedhojë e shtimit të numrit të këshilltarëve të njësisë së shërbimit ligjor, do të ishte më efikase zgjatja e mandatit të strukturave të vettingut dhe përmbyllja e këtij procesi nga të njëjtat institucione që jo vetëm e nisën atë, por edhe janë konsoliduar mjaftueshëm në këtë proces.

Të nderuar Deputetë,

Ajo çka e dimë me siguri dhe Komisioni Evropian e shpreh atë edhe në rekomandimet e tij është që institucionet e rivlerësimit kalimtar duhet të avancojnë procesin dhe të përmbyllin me sukses vettingun e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve të sistemit të drejtësisë.

Ndaj ju siguroj se kemi gjithë vullnetin e duhur dhe angazhimin tonë që këtë mission ta përmbyllim deri në fund këtë proces të nisur.

**Falënderit!**